



QASJA QYTETARE NË QEVERISJEN LOKALE

*PRISTUP
GRAÐANA U
LOKALNOJ
SAMOUPRAVI*



QASJA QYTETARE NË QEVERISJEN LOKALE

Prishtinë, nëntor 2013

PËRMBAJTJA

1. Rreth ATRC	3
1.1 Misioni i ATRC	3
2. Rreth projektit	4
3. Hyrje	5
4. Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal	6
5. Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale	7
5.1 Qasja në Dokumentet publike	8
6. Nivelet e pjesëmarrjes së qytetarëve	10
7. Procesi i vendimmarrjes	13
8. Proceset që ndikojnë në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje	15
9. Roli i fushatave avokuese në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje	16
10. Rekomandime për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale ...	16

1. RRETH ATRC

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar numër të madh të OJQ-ve në Kosovë duke synuar ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin në punën e tyre, krijimin dhe artikulumin e kërkesave të tyre dhe pajisjen me aftësi avokuese në strukturat e qeverisë në lidhje me çështjet që preokupojnë shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.
2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmoj organizatat joqeveritare lokale, përmes granteve kryesisht në avokim.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokoj në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, me të cilin ATRC synon të ofroj informacione në mënyrë elektronike, përmes informacioneve të freskëta në ueb faqe, diskutime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtim koalicioni, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu ofron librari me botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin.

1.1 Misioni i ATRC

Advocacy Training and Resource Center - ATRC është organizatë Kosovare jo-fitimprurëse, e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërmarrin kampanja avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativave qytetare, administratës publike, institucioneve politike, mediave, etj, pavarësisht nga bindjet dhe përkatësitë politike, fetare, etnike, etj.

2. RRETH PROJEKTIT

Advocacy Training and Resource Center – ATRC, me mbështetje financiare nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, nga marsi i vitit 2013 ka filluar së implementuari projektin “Fuqizimi i qytetarëve dhe komunave drejt zhvillimit demokratik”. Përmes këtij projekti ATRC ka synuar të kontribuoj në fuqizimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje, përmirësimin e marrëdhënieve në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve komunale dhe lehtësimin e mekanizmave të qeverisë lokale për angazhim të qytetarëve, që do të rezultojnë me inicimin e praktikave pjesëmarrëse në nivel lokal.

Projekti është implementuar në Komunën e Shtërpçës me ç’rast ATRC fillimisht ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Shtërpçës. Projekti ka vazhduar me organizimin e një sërë aktiviteteve, të përqendruara në ngritjen e kapaciteteve të qytetarëve dhe zyrtarëve komunal rreth përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, qeverisjes dhe buxhetimit me pjesëmarrje, si një mekanizëm që mundëson përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje që nga faza e planifikimit dhe deri tek implementimi dhe monitorimi e vlerësimi i projekteve.

“Qasja qytetare në qeverisjen lokale” është udhëzues i përgaditur nga ATRC, në të cilin janë përfshirë edhe rekomandimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe zyrtarëve komunal të Komunës e Shtërpçës, gjatë punëtorive dhe takimeve të organizuara.

3. HYRJE

Në Kosovë, pjesëmarrja qytetare, është e rregulluar dhe e garantuar me Kushtetutë dhe ligj. Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e publikut për të ndikuar në vendimet e institucioneve të shtetit. “Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal rregullohet përmes ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Qasje në dokumentet publike, Ligji për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare si dhe statutit dhe rregulloreve komunale.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale paraqet bazën ligjore për sistemin e vetëqeverisjes së komunave. Individët dhe OJQ-të mund të përfshihen në vendimmarrje në nivel lokal, përmes disa mënyrave. Megjithatë, edhe pse infrastruktura ligjore përcakton dhe obligon komunat të aplikojnë mënyrat dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në qeverisjen lokale, në përgjithësi mbetet akoma e ulët.

Qeveria Lokale është akteri kryesor i cili duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, megjithatë kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim mund të japin edhe Organizatat e Shoqërisë Civile. Ato në të shumtën e rasteve kanë informacionet dhe përvojën e nevojshme për të qenë partner të institucioneve në proceset vendimmarrëse dhe njëkohësisht të mobilizojnë publikun për çështje me interes për qytetarët në përgjithësi.

Ky publikim është udhëzues praktik, i cili paraqet mekanizmat kryesor të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal, të përcaktuara me ligjet e lartpërmendura si dhe rregulloret e Komunës së Shtërpcës, të cilat rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në komunë.

4. Pjesëmarrja e Qytetarëve në Nivel Lokal

Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal është proces, përmes së cilit mundësohet përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje. Përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes siguron ndikimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimet publike. Të gjithë qytetarët që janë të prekur nga një vendim i caktuar kanë të drejtën për t'u përfshirë në marrjen e atij vendimi.

Përfshirja e Qytetarëve në nivel lokal është e rëndësishme, sepse ajo ndikon në rritjen e legjitimitetit, efikasitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të qeverisë lokale karshi qytetarëve. Ajo ndihmon Qeverinë lokale në marrjen e vendimeve të drejta dhe njëkohësisht kontribuon në arritjen e qëllimeve të vetë qytetarëve. Pjesëmarrja qytetare fillon nga shpërndarja e informatave nga qeveria lokale, përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe deri tek aplikimi i proceseve pjesëmarrëse, si planifikimi dhe buxheti. Në këtë drejtim rritja e pjesëmarrjes në qeverisjen lokale ka të bëjë me rritjen e drejtpërdrejtë të përfshirjes së qytetarëve në marrjen e vendimeve, që nga faza e planifikimit dhe deri te monitorimi dhe vlerësimi.

Pjesëmarrja qytetare është tregues i rëndësishëm i nivelit të demokracisë. Niveli i ulët i pjesëmarrjes konsiderohet shenjë shqetësuese dhe faktor që ndikon në mosfunksionimin e demokracisë lokale. Qeveria Lokale është akteri kryesor, i cili duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Ajo, bazuar në infrastrukturën ligjore, duhet të krijoj kushtet dhe mekanizmat e duhur për përfshirjen e qytetarëve. Njëkohësisht, qeveria lokale duhet të përdor mënyra dhe mjete të ndryshme komunikimi për të nxitur kontributin e publikut. Në këtë mënyrë, Qeveria lokale duhet të lehtësoj dhe jo të pengoj qytetarët që të kenë një rol më aktiv. Ajo duhet t'i siguroj qytetarët që pjesëmarrja aktive e tyre do të jetë e dobishme dhe se rekomandimet e tyre do të merren parasysh dhe do të përfshihen në fazën finale të vendimmarrjes.

Nga ana tjetër duke patur parasysh se pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisjen lokale është edhe detyrë qytetare, qytetarët duhet të kenë vullnetin për të qenë pjesëmarrës aktiv. Ata duhet t'i njohin dhe t'i kuptojnë të drejtat e tyre për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Qytetarët në përgjithësi, përdorin mënyra dhe mjete të ndryshme duke u munduar ta përmirësojnë jetën e tyre. Ata shprehin nevojat dhe kërkesat e tyre përmes kërkesave, protestave, peticioneve, etj. Megjithatë, qytetarët, zakonisht, janë më aktiv rreth çështjeve që drejtpërdrejt ndikojnë në jetën e tyre dhe më pak në çështje të tjera të interesit të përgjithshëm.

5. MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË QEVERISJEN LOKALE

Në Kosovë, pjesëmarrja qytetare, është e rregulluar dhe e garantuar me Kushtetutë dhe ligj. Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e publikut për të ndikuar në vendimet e institucioneve të shtetit. “Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal rregullohet përmes ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Ligji për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare publike si dhe statutit dhe rregulloreve komunale.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale paraqet bazën ligjore për sistemin e vetëqeverisjes së komunave. Individët dhe OJQ-të mund të përfshihen në vendimmarrje në nivel lokal, përmes disa mënyrave. Kreu IX i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale përcakton mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve. Ky ligj bazohet mbi parimet e garantimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, përmes përcaktimeve ligjore të mënyrave të komunikimit në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Ligji karakterizon takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij të hapura për publikun. Ligji parasheh gjithashtu, që komunat të mbajnë së paku dy takime publike në vit, ku mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Këto takime shërbejnë si mjet informues për qytetarët, por edhe si mekanizëm për marrjen e sugjerimeve nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur komunal. Nëse bëhet një pyetje në takim publik dhe për të cilën nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh pas ditës së takimit.

Në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, pjesëmarrja qytetare në nivel lokal rregullohet me Statut, rregullore për transparencë, rregulloren për qasje në dokumente publike, rregulloren për bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, etj. Në këtë mënyrë komunat kanë krijuar mekanizmat ligjor për përfshirje të qytetarëve në qeverisjen lokale, siç janë

Tubimet me publikun, Konsultimet, zgjedhja e këshillave lokale dhe themelimi i komiteteve konsultative, që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës. Komunat e Kosovës, gjatë një viti, organizojnë nga dy takime me publikun, megjithatë pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime nuk është e mjaftueshme.

Veç takimeve me publikun komuna garanton edhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, përmes konsultimit me publikun. Neni 15.1 i Statutit të Komunës së Shtërpcës përcakton se Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara në fakte dhe se janë marrë parasysh edhe përvojat e qytetarëve. Gjithashtu, Rregullorja për transparencë e Komunës së Shtërpcës përcakton se rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen.

Themelimi i Komiteteve konsultative, në kuadër të Kuvendit të komunës është një mekanizëm tjetër, i garantuar me ligjin për vetëqeverisjen lokale, për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës. Secili kuvend komunal mund të themelojë komitete konsultative, ku sipas nenit 73.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale: Anëtarësi e

komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Kuvendi Komunal i Shtërpcës nuk ka themeluar komitete konsultative.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal më 15 korrik, të vitit 2008, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/8 “Për Marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane”, i cili obligon komunat që me statut dhe rregullore lokale të përcaktojnë strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane si dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Në vitin 2012 Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka aprovuar Rregulloren për Organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Shtërpcës, si dhe gjatë vitit 2013 ka themeluar gjithsej 16 Këshillat lokale, në fshatra dhe në qytet.

Për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal dhe për të lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës Neni 68.4 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale obligon komunat që të miratojnë rregullore për transparencë. “Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Në vitin 2010 Kuvendi i Komunës së Shtërpcës ka aprovuar rregulloren për transparencë dhe gjithashtu Rregulloren mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës, e cila përcakton edhe hartimin e Planit për informim dhe komunikim me publikun. Ky plan hartohet nga zyra përgjegjëse për informim në bashkëpunim me kryetarin, drejtoritë, Kryesuesin dhe sekretarinë e Kuvendit të Komunës.

Planin për informim dhe komunikim me publikun në Komunën e Shtërpcës përmban:

Aktivitetet për informim dhe komunikim me publikun

Kohën e realizimit të tyre

Personat përgjegjës për realizimin e planit

Koston financiare për implementimin e planit

Hapat konkret për shpërndarjen e informacionit përmes: tabelave informuese, të cilat vendosen në lokacionet brenda territorit të Komunës; buletinëve komunal, faqes elektronike të Komunës dhe broshurave.

5.1 Qasja në Dokumentet publike

Përmes Ligjit për Qasje në dokumentet publike të gjithë qytetarëve u jipet mundësia të kenë qasje në dokumentet publike të institucioneve. Ligji përcakton se të gjitha institucionet janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente.

Kështu qytetarët të gjitha kërkesat për qasje në dokumente duhet t’ia drejtojnë zyrtarit për komunikim me qytetarët. Kërkesa duhet mund të jetë e drejtpërdrejtë, me shkrim apo në formë elektronike. Zyra për komunikim me qytetarë mban evidencë të saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo të rrefuzuar të këtyre kërkesave. Gjithashtu, Zyra për komunikim me qytetarët përgadit raporte të rregullta dhe këto raporte ia dërgon njësisë përkatëse të komunës, zyrës së Kryetarit i cili

pastaj përgadit raportin gjithpërfshirës të institucioneve publike të Komunës për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Kërkuesi i dokumentit nuk është i obliguar të jap arsyet se përse kërkon qasje në dokument. Nëse kërkesa nuk është e saktë sa duhet, atëherë zyra për komunikim me qytetarë mund të kërkoj nga kërkuesi, por edhe i ndihmon atij në sqarimin e kërkesës. Zyra për komunikim me qytetarë nuk duhet të zbuloj identitetin e parashtruesit të kërkesës ndaj palëve të treta dhe gjithashtu kjo zyre duhet t'ju ofroj informata dhe ndihmë se si dhe ku mund të parashtrohen kërkesat për qasje në dokumente publike.

Pas parashtrimit të kërkesës për qasje në dokument publik, Zyra për komunikim me qytetarët obligohet që brenda shtatë dite, në bashkëpunim me Zyren e ekzekutivit të komunës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokument ose të jap përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe njëkohësisht e informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Në qoftëse kërkesa refuzohet pjesërisht apo e plotë, kërkuesi ka të drejtë që brenda 15 ditësh nga dita e marrjes së përgjigjes nga institucioni publik të parashtroj kërkesë për rishqyrtimin e çështjes, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit.

Nëse autoriteti publik nuk i përgjigjet kërkesës për qasje në një dokument zyrtar, kjo konsiderohet si përgjigje negative dhe kërkuesi ka të drejtë që të filloj procedurën para Ombudspersonit, institucione tjera publike apo në gjykatë.

Në Komunën e Shtërpçës gjatë vitit 2013 ka patur vetëm një kërkesë për qasje në dokumente publike.

Mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së qytetarëve

Mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së qytetarëve, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale janë edhe e drejta e peticionit, iniciativat qytetare, kërkesa për referendum komunal etj.,

Qytetarët kanë të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur më përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës.

Qytetarët mund të inicojnë draft rregullore për konsiderim nga një kuvend komunal. Një draft rregullore e prezantuar me iniciativën e qytetarëve duhet të nënshkruhet nga së paku 15 përqind e votuesve të regjistruar në komunë. Rregullorja e propozuar duhet të trajtoj një çështje mbi të cilën komuna ka kompetenca. Kur kuvendit i prezantohet një rregullore e tillë, kuvendi komunal duhet ta konsideroj atë dhe të veproj brenda 60 ditëve pas pranimit. Qytetarët gjithashtu mund të kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës e miratuar nga kuvendi i komunës, t'i nënshtrohet referendumit. Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar. Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditëve pas pranimit të peticionit sipas ligjit në fuqi.

Edhe pse Qeveria Lokale është akteri kryesor, i cili duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje mund të japin edhe Organizatat e Shoqërisë Civile. Ato ju shërbejnë në masë të madhe interesave të qytetarëve, duke avokuar te institucionet lokale, duke

edukuar publikun, tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve me rëndësi publike, duke monitoruar punën e institucioneve si dhe duke ofruar sugjerime dhe rekomandime konkrete për çështje të ndryshme. Organizatat e shoqërisë civile në të shumtën e rasteve kanë informacionet dhe përvojën e nevojshme për të qenë partner të institucioneve në proceset vendimmarrëse dhe njëkohësisht të mobilizojnë publikun për çështje me interes për qytetarët në përgjithësi.

6. NIVELET E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE

Nivelet kryesore të pjesëmarrjes së qytetarëve janë: informimi, konsultimi, diskutimi dhe partneriteti. Në vazhdim është paraqitur rëndësia e këtyre niveleve në procesin vendimmarrës si dhe aplikimi i tyre në nivelin lokal.




Fig: Nivelet kryesore të pjesëmarrjes së qytetarëve

- **Informimi i qytetarëve**

Informimi i qytetarëve nënkupton mundësinë e qytetarëve për të pasur qasje në informata, lidhur me politikat, vendimet dhe veprimet e qeverisë lokale. Qytetarët gjithashtu, duhet të jenë të informuar për të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë që ata kanë për t'u përfshirë në qeverisjen lokale. Informimi është elementi kryesor drejt një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme dhe gjithashtu krijon mundësi për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Ligji për vetëqeverisjen lokale obligon komunat që t'i informojnë qytetarët për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik. Gjithashtu, neni 4.5 i Rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës përcakton se të gjitha rregulloret, procesverbalet dhe vendimet, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, publikohen në ueb faqen e Komunës së Shtërpcës, tetë ditë pas mbajtjes së mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet. Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës, përcakton se në ueb faqen e Komunës veç statutit, rregulloreve, vendimeve të Kryetarit dhe të Kuvendit, raporteve financiare, të auditimit, etj, të përmbaj edhe planin e veprimit për transparencë në procesin e hartimit të buxhetit.

Komunat e Kosovës në përgjithësi aplikojnë disa mjete për informim të qytetarëve. Ndër mjetet kryesore të përdorura janë ueb faqja e komunës, mediat, shpalljet, etj. Përmes ueb faqes së komunës qytetarët mund të informohen për aktivitetet e komunës dhe të arriturat e saj dhe gjithashtu janë të vendosura statuti i komunës, rregulloret komunale, vendimet, buxheti i aprovuar, etj. Megjithatë, aplikimi i mjeteve informuese të lartpërmendura mundëson informimin e qytetarëve, por jo edhe mundësinë që ata të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre.

Takimet publike të organizuara nga komuna janë mënyra më e aplikuar nga komunat në përgjithësi, edhe pse pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime nuk është e mjaftueshme. Ndonëse, janë mundësi për qytetarët që të kenë një komunikim të drejtpërdrejtë me zyrtarët komunal, qytetarët nuk i vlerësojnë ato si mënyra të efektshme komunikimi dhe kjo për shkak të mundësisë së vogël për të ndikuar në rezultatin e një vendimi apo të një çështjeje të caktuar. Takimet e organizuara me qytetarë në fshatra dhe lagje vlerësohen si më efektive, në krahasim me takimet publike të organizuara në komunë.

Neni 7.8 i Rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës përcakton se takime me qytetarë mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara Urbane, nga Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij. Gjithashtu, Rregullorja për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Shtërpcës përcakton se takimet me qytetarë mund të organizohen edhe me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane

Gjatë vitit 2013 Komuna e Shtërpcës veç dy takimeve publike të mbajtura në Komunë, ka organizuar edhe 16 takime me qytetarë.

- **Konsultimi**

Konsultimi me publikun paraqet nivelin e dytë të pjesëmarrjes së qytetarëve, përmes së cilit qytetarët kanë mundësi të jenë pjesëmarrës aktiv. Në këtë mënyrë qytetarët mund të paraqesin opinionin e tyre, sugjerimet, rekomandimet dhe vërejtjet për çështje të caktuara, gjë që ndihmon edhe qeverinë lokale në marrjen e vendimeve më të drejta dhe efektive në lidhje me identifikimin e nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve dhe politikave publike në përgjithësi.

Komunat janë të obliguara me statute komunale të konsultojnë publikun. Bazuar në nenin 15.1 të Statutit të Komunës së Shtërpcës "Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte dhe se janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, si dhe të gjitha gjitha vendimet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë. Poashtu, neni 15.2 përcakton se Komuna gjithashtu duhet të përkujdeset që qytetarët të kenë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre të merren parasysh. Sipas statutit konsultat me publikun mund të mbahen nga Kuvendi komunal, komitetet e tij dhe Kryetari i komunës do të kenë autoritetin që të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që është në kompetencat e tyre.

Rregullorja për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Shtërpcës përcakton se së paku një anëtar i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale, që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.

Format e konsultimit të cilat mund t'i shfrytëzoj komuna, sipas Statutit të Komunës së Shtërpcës janë:

- a) Fushata informative dhe të publicitetit për promovimin e programeve dhe të aktiviteteve komunale;
- b) Kontaktet me grupet e fokusit, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;
- c) Anketa që kanë të bëjnë me implementimin e politikës;
- d) Shpalljet publike të propozimeve lidhur me politikën apo Projekt-Rregulloret, duke ftuar pjesëmarrjen me prezantime;
- e) Kontakte të rëndësishme me grupet përkatëse të interesit;
- f) Takime publike;
- g) Dëgjimet publike dhe
- h) Studime për vlerësimin e ndikimit.

Konsultat me publikun, pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, duhet të publikohen në Faqen Zyrtare të Komunës dhe gjithashtu, Komuna duhet të ofroj kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe informacioneve me shkrim. Neni 20.1 i Statutit të Komunës së Shtërpcës përcakton se Komuna duhet t'i lejojë së paku 8 javë dhe më së shumti 12 javë për dhënien e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut. Komuna analizon përgjigjet dhe rezultatet bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet gjithashtu të publikohen në Faqen Zyrtare të Komunës.

• Diskutimi

Përveç nevojës për informim të drejtë, qytetarët gjithashtu mund të kontribuojnë në ofrimin e informatave të nevojshme për qeverinë lokale dhe të luajnë një rol efektiv në vendimmarrje.

Neni 8.1 i Rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës përcakton organizimin e diskutimit publik para miratimit të rregulloreve dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës: "Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen". Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, mediave të shkruara dhe ueb faqes së Komunës. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqaroj përmbajtjen e aktit para publikut. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si

dhe ato të marra parasysish. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

- **Partneriteti**

Partneriteti është niveli më i lartë i përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen lokale. Bashkëpunimi, partneriteti, koordinimi i veprimeve në mes organizatave të shoqërisë civile, grupeve të qytetarëve në njërën anë si dhe institucioneve publike është jetik dhe përcaktues për nivelin e demokracisë në vend në përgjithësi si dhe transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Partneriteti nënkupton njohjen e përgjegjësisë së përbashkët. Kur qytetarët ndjejnë se janë partnerë në qeveri, ata do t'a rikthejnë besimin ndaj qeverisë lokale.

PARTNERITET	Bashkëpunim dhe koordinim i veprimeve në mes organizatave të shoqërisë civile, grupeve të qytetarëve dhe institucioneve publike
KONSULTIM/ DISKUTIM	Takimet me grupet e interesit Anketat që kanë të bëjnë me implementimin e politikës Pjesëmarrje në grupe punuese në Kuvendin Komunal për hartimin e rregulloreve Komitetet këshillëdhënëse Takimet publike Dëgjimet publike Studimet për vlerësim të efektit Diskutimi publik para miratimit të rregulloreve dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës
INFORMIM	Shpalljet publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës Mediat e shkruara dhe elektronike Ueb faqja zyrtare e Komunës Fushatat informative Broshurat Tabelat informuese Buletinët komunal

Fig: Mënyrat e bashkëpunimit në mes qytetarëve dhe komunës

7. PROCESI I VENDIMMARRJES

Përmes pjesëmarrjes qytetare Qeveria lokale synon t'i informoj qytetarët për vendimet e marra apo t'i përfshij qytetarët në vendimmarrje. Shumë çështje për të cilat vendoset në nivel lokal në përgjithësi i takojnë synimit të parë. Pra, në përgjithësi, qeveritë lokale më tepër i informojnë qytetarët për vendimet e marra, sesa bëjnë përpjekje t'i përfshijnë ata drejtpërdrejt në vendimmarrje. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve është e domosdoshme në

të gjitha fazat e procesit vendimmarrës, duke filluar nga planifikimi, diskutimi, marrja e vendimit, implementimi dhe monitorimi.

Planifikimi- Marrja e një vendimi pa planifikim nuk sjell një vendim efektiv. Faza e planifikimit mundëson lehtësimin e vendimit, andaj është e rëndësishme që në këtë fazë të përfshihen të gjitha palët me interes. Qytetarët duhet të përfshihen në fazën e planifikimit, si gjatë hartimit të një rregulloreje, identifikimit të nevojave të qytetarëve apo të një çështje tjetër me interes për ta.

Konsultimi/diskutimi- Qëllimi kryesor i konsultimit është që të mundësoj pjesëmarrjen aktive dhe të efektshme të individëve dhe komuniteteve në vendimmarrje. Qeveria lokale duhet të siguroj që të gjithë ata që janë ose mund të ndikohen nga vendimi t'i përfshij në fazën e konsultimit. E rëndësishme është që qeveria lokale të ofroj informacione të qarta dhe të nevojshme rreth çështjes për të cilën zhvillohet konsultimi.

Marrja e vendimit- Para marrjes së vendimit qeveria lokale duhet t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet e paraqitura nga qytetarët, gjatë fazës së konsultimit.

Implementimi- Procesi i vendimmarrjes nuk përfundon me marrjen e një vendimi. Ndonëse fazat paraprake janë shumë të rëndësishme, mënyra e zbatimit të vendimeve mund të jetë po aq e rëndësishme, meqë ka raste kur vendimet ngecin pikërisht në fazën e implementimit. Monitorimi dhe vlerësimi si faza të mëtejme do të tregojnë nëse vendimi ka qenë apo jo cilësor dhe i efektshëm.

Monitorimi dhe vlerësimi- Monitorimi përfshin mbikqyrjen e aktiviteteve për të përcaktuar nëse një vendim është duke u zbatuar ashtu siç është planifikuar. Kurse, vlerësimi përfshin analizimin e aktiviteteve dhe ndikimit për të përcaktuar nëse ato janë duke i kontribuar qëllimit kryesor.

Përfshirja e qytetarëve në monitorim dhe vlerësim kontribuon në rritjen e transparencës përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve komunal ndaj qytetarëve si dhe ofron mundësinë e përmirësimit dhe ofrimit të shërbimeve publike më cilësore, të cilat janë esenciale për mirëqenien e qytetarëve.

Nga praktika e deritanishme ka patur mjaft raste kur Qeveria lokale ka përfshirë qytetarët vetëm në një apo në disa faza të procesit të vendimmarrjes. Edhe pse përfshirja e qytetarëve në tërë procesin e vendimmarrjes nuk është e lehtë, ajo kontribuon jo vetëm në sigurimin e informatave më të plota rreth një çështjeje të caktuar, por edhe që vendimi të jetë më efektiv dhe i aplikueshëm në praktikë.

Infrastruktura ligjore ekzistuese në Kosovë edhe në nivel lokal ofron disa mundësi për qytetarët dhe grupet formale që të përfshihen në proceset vendimmarrëse, duke filluar që nga e drejta e qytetarëve për:

- Pjesëmarrje në takimet publike, të organizuara nga Kuvendi Komunal
- Pjesëmarrje në grupe punuese në Kuvend Komunal për hartimin e rregulloreve
- Peticioni
- Inicimi për konsiderim i një rregulloreje dhe

- Kërkimi i referendumit në nivel lokal.

Pjesëmarrja në grupe punuese në Kuvend Komunal për hartimin e rregulloreje është mënyra më e mirë për të dhënë kontributin tuaj dhe njëkohësisht për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin dhe ndryshimin e saj.

Një nga format e konsultimit të përcaktuara me Statutin e Komunës së Shtërpçës janë edhe studimet për vlerësim të ndikimit. Në këtë mënyrë komuna mund të konsultoj qytetarët se çfarë ndikimi ka patur tek ta një rregullore, vendim apo sa janë të kënaqur qytetarët me shërbimet publike të ofruara nga komuna. Nëse kjo formë aplikohet nga komuna, atëherë mund të themi se qytetarët janë përfshirë në vlerësimin e një politike publike apo cilësinë e shërbimeve publike, varësisht se çfarë përfshin vlerësimi.

8. PROCESET QË NDIKOJNË NË PËRFSHIRJEN E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

8.1 Planifikimi me pjesëmarrje

Planifikimi me pjesëmarrje është një proces, që mundëson përfshirjen e qytetarëve që nga faza e parë e identifikimit të çështjeve. Në nivel lokal planifikimi me pjesëmarrje është veçanërisht i nevojshëm për identifikimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Në këtë mënyrë qytetarët do të jenë ata që do t'vëndosin për përcaktimin e prioriteteve të tyre. Në kohën e fundit, në disa komuna të Kosovës, ka filluar të aplikohet procesi i planifikimit kooperues, përmes organizimit të takimeve të veçanta me qytetarë, në fshatra dhe në lagje. Në këtë drejtim, ATRC ka kontribuar në inicimin e këtij procesi në komunat e regjionit të Prizrenit, Pejës dhe të Gjilanit, duke identifikuar nevojat e qytetarëve të të gjitha fshatrave dhe lagjeve të këtyre komunave. Komunat e Kosovës duhet të vazhdojnë të aplikojnë këtë praktikë dhe për më tepër ato duhet të aplikojnë këtë proces deri në fazën e vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët jo vetëm të paraqesin, por edhe të vendosin për prioritetet e tyre.

8.2 Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një proces që ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e çështjeve financiare. Ky është një mekanizëm që përfshin dhe i fuqizon qytetarët duke siguruar një shpërndarje më të barabartë të investimeve. Pas identifikimit të nevojave dhe rekomandimeve të qytetarëve, përmes organizimit të takimeve të veçanta me qytetarë në fshatra dhe në lagje, vazhdohet me hapin e dytë të këtij procesi i cili përfshin organizimin e takimeve të dyta, në të cilat qytetarët vendosin prioritetet e tyre. Zgjedhja e prioriteteve bëhet përmes një procesi demokratik, qoftë përmes votimit të drejtpërdrejtë gjatë takimit ose përmes fletëve të votimit që qytetarët i plotësojnë dhe i hedhin në vende të caktuara.

Hapi i tretë i rëndësishëm është themelimi i grupit përfaqësues të qytetarëve. Qytetarët përzgjedhin anëtarët e grupit, të cilët do të marrin pjesë apo monitorojnë marrjen e vendimeve rreth projekteve të cilat do të implementohen nga komuna.

Përmes aplikimit të procesit i buxhetimit me pjesëmarrje arrihet shpërndarja proporcionale e investimeve, duke iu mundësuar kështu që të gjithë qytetarëve pa dallim të përfitojnë nga ky proces dhe në veçanti qytetarët e zonave rurale apo të lagjeve të cilët për arsye të ndryshme deri më tani kanë përfituar më pak.

9. ROLI I FUSHATAVE AVOKUESE NË PËRFSHIRJEN E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Përveç mekanizmave ekzistues në nivel lokal, organizimi i fushatave avokuese është një mundësi tjetër përmes së cilës qytetarët, grupet joformale dhe organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë në rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe ndikimin në politikat publike. Kontributi i fushatave avokuese të tyre mund të fokusohet në disa drejtime: 1. Avokimi në krijimin apo ndryshimin e rregulloreve, planeve, etj të parapara me ligje dhe rregulloret komunale; 2. Avokimi për themelimin apo funksionalizimin e mekanizmave/strukturave të nevojshme për implementimin e tyre dhe 3. Informimi dhe edukimi i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal rreth çështjes për të cilën avokohet.

Që fushata avokuese të jetë e suksesshme duhet paraprkasht që grupi avokues të definoj çështjen për të cilën do të avokohet, pastaj qëllimin dhe përcaktimin e objektivave konkrete, identifikimin e vendimmarrësve primar dhe sekondar, përcaktimin e strategjive dhe taktikave avokuese, identifikimin e palëve me interes, definimin e mesazhit të fushatës, ndërtimin e përkrahjes dhe monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të fushatës.

10. REKOMANDIME PËR RRRITJEN E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË QEVERISJEN LOKALE

- Të aplikohen mjete të ndryshme komunikimi, përmes së cilave qytetarët do të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre.
- Para organizimit të takimeve publike, të informohen organizatat e shoqërisë civile për rendin e ditës së atij takimi si dhe materiale tjera shtesë, kur është e mundur, në mënyrë që të jenë pjesëmarrës aktiv të atij takimi.
- Të organizohen takime periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje.
- Të themelohen Komitete konsultative për pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje, në veçanti për buxhetim me pjesëmarrje.
- Të fuqizohen Këshillat e Lokale përmes rritjes së bashkëpunimit me Komunën dhe qytetarët.
- Organizatat e shoqërisë civile të jenë më aktive në informimin dhe avokimin publik të qytetarëve, për të qenë pjesë e vendimmarrjes në nivel lokal.

Literatura dhe referencat:

Avokimi në Kosovë, Advocacy Training and Resource Center-ATRC

Citizen Participation in Local Government Budgeting, Maureen Berner

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-040, 2008

Ligji për Qasje në dokumentet publike, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-215, 2010

Udhëzimi Administrativ Nr 2008/28 “Për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane”, Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Udhëzimi Administrativ Nr.2008/10, “Për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna”, Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Statuti i Komunës së Shtërpcës, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, Nr.01/898, 2010

Rregullore për transparencën, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, 01.Nr.895, 2010

Rregullore mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për transparencë të Komunës së Shtërpcës, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës, Nr. 01/895, 2010

Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Shtërpcës, 01-16-1541, 2012

Falenderim

ATRC falenderon komunën Hani i Elezit, në veçanti Kryetarin e Komunës, Zyren për informim publik dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për përkrahjen dhe bashkëpunimin gjatë implementimit të projektit.



